



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:095200

Datë: 23.12.2024

Numri i dokumentit: 06640905

PKR.nr.596/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Gazmend Bahtiri, me anëtarët e trupit gjykues - gjyqtarët profesionist Alltën Murseli dhe Gëzim Ademi, me bashkëpunëtoren profesionale Albana Curri dhe procesmbajtësen Dalina Kërçeli – Abdullahu – zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarve: S.D për shkak të veprës penale Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik nga neni 415 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPRK), e ri – cilësuar nga gjykata dhe A.D, për shkak të veprës penale në Bashkëkryerje Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik nga neni 415 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, e evidentuar nën shenjë PP/I.nr.44K/22, e datës 21 nëntor 2022, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor – publik, i mbajtur më 21 nëntor 2024, në prezencën e Prokurorit të shtetit F. S., të akuzuarit S.D me mbrojtësin e tij sipas autorizimit avokat D.S, si dhe të akuzuarit A.D me mbrojtësin e tij sipas autorizimit avokat V.O, më 25 nëntor 2024 publikisht shpalli, ndërsa më 23 dhjetor 2024, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S.D, nga i ati A. dhe nëna N. (e vajzërisë H.), i lindur më në, ku edhe jeton me adresë: rruga, me numër personal të identifikimit të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre (3) fëmijëve, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, punon në biznes

të djalit të tij, i gjendjes së mesme ekonomike, Nacionaliteti - Turk, shtetas i Republikës së Kosovës, sipas të dhënave të evidencës penale, rezulton se ka qenë i dënuar edhe më parë, ka qëndruar në ndalim nga data 12 maj 2022, deri me datë 13 maj 2022.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

I akuzuari S.D - Përfaqësues i kompanisë, me vetëdije ka shkelur rregullat e prokurimit publik duke paraqitur dokumentacion të rremë, në atë mënyrë që ka përpiluar kontrata fiktive kinse të lidhura mes kompanisë L.L.C dhe kompanive “R....” SHA, N.T.P “D....” dhe KS “R.S. ” të cilat i kanë paraqitur si referenca në dosjet e tenderëve në vitin 2021, të cilat referenca nuk janë fare të deklaruara në qarkullimin e Administratës Tatimore të Kosovës sipas procedurave fatura shitje - blerje dhe në Bankën Kombëtare Tregtare, si dhe ka falsifikuar dokumentin e datës 14 tetor 2022 kinse të lëshuar nga BKT, të cilin dokument e ka përdorur në procesin e tenderimit, me ç’rast i njëjti ka vënë në lajthim autoritetet kontraktuese dhe ka arritur që të nënshkruaj tre kontratat me Institucionet e Republikës së Kosovës, dhe atë me datën 20 janar 2021 Operatori Ekonomik LLC, ka lidhur kontratë me Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK) për “Sigurim Fizik për KM”, vlera e kontratës 18,000.00 euro, më 14 maj 2021 ka lidhur kontratë me Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për “Mirëmbajtjen Higjienike” të Objektivit të Sekretariatit të KGJK-së, Graçanicë dhe Objektivin e Divizionit të Gjykatës së Apelit me seli në Mitrovicën e Veriut, vlera e kontratës 65,244.96 euro dhe më datë 26 prill 2021 ka lidhur kontratë me Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve për “Pastrimin dhe Mirëmbajtjen” e Objektivit në shfrytëzim nga MFPT, vlera e kontratës 11,149.92 euro.

Me këto veprime ka kryer ka kryer veprën penale Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik nga neni 415 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, nenin 415 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 dhe 4 të KPRK-së, si dhe neneve 358, 360, 361, 363, 364, 365, 367, 368, 369, 449, 452 dhe 453 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPPRK) të akuzuarin e:

G J Y K O N

Me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjet, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në kuadër të dënimit me burgim i llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim, nga data 12 maj 2022 deri me datë 13 maj 2022.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund t'a paguaj gjobën e lartcekur, gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë në dënim me burgim, duke e llogaritur 20,00 (njëzet) euro, e barabartë me një (1) ditë burgim.

DETYROHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor, të e paguajë shumën 200,00 (dyqind) euro dhe në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit, shumën prej 50,00 (pesëdhjetë) euro, e gjitha këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të akuzuarit të lartcekur i shqiptohet edhe ndalimi i marrjes pjesë në procedurat për dhënien e kontratave në prokurim publik në kohëzgjatje prej tre (3) viteve.

Ndërsa i akuzuari:

A.D nga i ati S. dhe nëna A. (e vajzërisë B.), i lindur me datë, ku edhe jeton, adresa, rruga, me numër personal të identifikimit të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, punon në biznes personal LLC, i gjendjes së mesme ekonomike, Nacionaliteti - Turk, shtetas i Republikës së Kosovës, sipas të dhënave të evidencës penale, rezulton se ka qenë i dënuar edhe më parë, ka qëndruar në ndalim nga data 12 maj 2022 deri me datë 13 maj 2022.

Konform nenit 363 paragrafi 1, nëparagrafi 1.3 të KPPRK-së:

LIROHET NGA AKUZA

SEPSE:

I akuzuari A.D - Pronar i Kompanisë LLC në bashkëkryerje me të akuzuarin S.D - Përfaqësues i kompanisë, me vetëdije kanë shkelur rregullat e prokurimit publik duke paraqitur dokumentacion të rremë, në atë mënyrë që kanë përpiluar kontrata fiktive kinse të lidhura mes kompanisë L.L.C dhe kompanive “R...” SHA, N.T.P “D...” dhe K.S “R.S.” të cilat i kanë paraqitur si referenca në dosjet e tenderëve në vitin 2021, të cilat referenca nuk janë fare të deklaruara në qarkullimin e Administratës Tatimore të Kosovës sipas procedurave fatura shitje - blerje dhe në Bankën Kombëtare Tregtare, si dhe kanë falsifikuar dokumentin e datës 14 tetor 2022 kinse të lëshuar nga BKT, të cilin dokument e kanë përdorur në procesin e tenderimit, me ç’rast të njëjtit kanë vënë në lajthim autoritetet kontraktuese dhe kanë arritur që të nënshkruajnë me Institucionet e Republikës së Kosovës, dhe atë me datën 20 janar 2021 Operatori Ekonomik LLC, ka lidhur kontratë me Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK) për “Sigurim Fizik për KM”, vlera e kontratës 18,000.00 euro, më 14 maj 2021 ka lidhur kontratë me Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për “Mirëmbajtjen Higjienike” të Objektivit të Sekretariatit të KGJK-së, Graçanicë dhe Objektivin e Divizionit të Gjykatës së Apelit me seli në Mitrovicën e Veriut, vlera e kontratës 65,244.96 euro dhe më 26 prill 2021 ka lidhur kontratë me Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve për “Pastrimin dhe Mirëmbajtjen” e Objektivit në shfrytëzim nga MFPT, vlera e kontratës 11,149.92 euro.

Me këto veprime kishte për të kryer veprën penale në bashkëkryerje Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik nga neni 415 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 3, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Shpenzimet e procedurës penale, në raport me pjesën liruese, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Historiku i procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, në këtë gjykatë me 21 nëntor 2022, ka paraqitur aktakuzën të evidentuar nën shenjën PP/I.nr.44K/22, të datës 21 nëntor 2022, kundër të akuzuarve S.D dhe A.D për shkak të veprës penale në bashkëkryerje

Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik nga neni 415 paragrafi 1 dhe 3, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Shqyrtimi fillestar

Gjykata në kuadër të kompetencës territoriale dhe lëndore më 20 mars 2024 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale, ku kanë prezantuar të gjitha palët në procedurë, e cila seancë është shtyrë pasi që mbrojtësit e të akuzuarve kanë kërkuar sqarime shtesë nga përpiluesi i aktit akuzues (i cili i ka zhvilluar hetimet). Më 26 prill 2024, është caktuar dhe mbajtur seanca tjetër fillestare, ku kanë prezantuar të gjitha palët në procedurë dhe pasi që gjykata ishte siguruar që të njëjtit e kanë kuptuar aktakuzën dhe nuk kanë pasur nevojë për sqarime shtesë, të akuzuarit janë deklaruar jo fajtor përkitazi me veprën penale në fjalë, për çka gjykata të njëjtit dhe mbrojtësit e tyre i ka njoftuar me të drejtat e tyre konform nenit 240 paragrafi 7 të KPPRK-së.

Mbrojtësit e lartcekur të te akuzuarve në afatin ligjor kanë parashtruar kërkesa për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, të cilat janë refuzuar me aktvendimin e kësaj gjykate, nën shenjën PKR.nr.596/22, të datës 27 qershor 2024, i cili vendim është vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, i evidentuar nën shenjën PN.nr.1200/24, të datës 06 gusht 2024.

Shqyrtimi gjyqësor

Gjykata me datat: 10 tetor 2024, 08 nëntor 2024 dhe 21 nëntor 2024, ka caktuar dhe mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, ku kanë prezantuar të gjitha palët në procedurë. Të akuzuarit fillimisht kanë deklaruar se e kuptojnë dhe e flasin mirë gjuhën shqipe dhe se nuk kanë nevojë për përkthim, marrë parasysh faktin se të dy i përkasin nacionalitetit turk. Po ashtu në shqyrtimin gjyqësor të akuzuarit janë deklaruar jo fajtor lidhur me veprën penale.

Fjala hyrëse e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën hyrëse ka deklaruar se gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë gjatë këtij shqyrtimi do të vërtetohet nga të gjitha provat e përshkruara në propozimin e aktakuzës.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.D - avokat D.S, në fjalën hyrëse ka deklaruar se e kundërshtojmë aktakuzën dhe se prokuroria me asnjë provë nuk ka vërtetuar se i akuzuari S.D ka shkelur rregullat e prokurimit publik.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.D - avokat V.O, në fjalën hyrëse ka deklaruar se me administrimin e provave do të vërtetohet se i mbrojturi im nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që do të përbënte element të veprës penale për të cilën akuzohet.

Procedimi i provave personale

Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me dëgjimin e dëshmitarit M.H. i cili ndër të tjera ka deklaruar se punën në kompaninë LLC, e ka filluar nga viti 2017, e në të cilën kompani punon edhe sot, e që pronar i të cilës kompani ka qenë S.D, ku posedon dëshminë (certifikatën e biznesit që ka qenë e regjistruar në emër të S.D.). Edhe gjatë vitit 2020 ka punuar aty dhe se prej asaj kohe ka punuar vetëm në këtë kompani dhe ishte marrë me prokurim elektronik (në vitin 2020 nuk ka pasur njohuri se kush ka qenë pronar i kompanisë). Pozita e tij në këtë kompani sipas kontratës ka qenë menaxher i sigurimit fizik, ndërsa detyra e tij ka qenë të merret me prokurim elektronik, në të cilën detyrë ishte ngarkuar nga S.D (i cili edhe e kishte punësuar). Në raport me dosjet për tenderë i njëjti ka përgatitur listën e dokumenteve të kërkuara dhe atë listë ia ka dorëzuar të akuzuarit S.D. i cili e ka furnizuar me të gjitha dokumentet e kërkuara. Çdo dokument për aplikim (për tender) e ka pranuar nga S.D ngase i njëjti nuk kishte nxjerrë dokumente, mirëpo pa dijeni se nga kush kanë qenë të vulosura. Dokumentet i kanë kaluar fizikisht në letër, të cilat i ka skenuar dhe dorëzuar për tender në mënyrë elektronike dhe nuk i ka interesuar se a është nënshkruar fizikisht apo me nënshkrim të deponuar në vulë. Bashkëpunimi i tij në kompani ka qenë vetëm me S.D dhe vetëm atij i përgjigjet. Sa i përket raportit me A.D e ka thënë me plotë përgjegjësi se nuk kishte pasur kurrfarë kontakti lidhur me detyrën që e kishte bërë nga i njëjti asnjëherë nuk kam kërkuar asgjë dhe asnjëherë nuk më ka pyetur për punën që unë e bëj. Lidhur me rrjedhën e procedurës së tenderimit ka treguar se në listën që e kërkon i njëjti për aplikimin për tender janë dokumentet bazë si: Certifikata e biznesit, certifikata e TVSH-së dhe zakonisht kërkohet në 99% të rasteve qarkullimi me ATK-

në dhe dokumentet e tjera si: deklarata nën betim, të cilat të kompletuara i ka pranuar nga S.D, i cili e cakton edhe çmimin e tenderit. Asnjëherë aplikacioni për tender nuk ka qenë i nënshkruar nga A.D, me të cilin nuk kishte pasur kurrfarë kontakti lidhur me dosjet e tenderëve. E-prokurimi figuron në emër të S. D. dhe dëshmitari ka leje që të hyjë të kontrolloj, aplikoj etj... i njëjti përcjellë edhe shpalljen e tenderit, fituesit deri në përfundim të procedurës dhe vazhdimisht e njofton të akuzuarin S.D, për kërkesat eventuale nga autoriteti kontraktues. Lidhur me verifikimin e dokumentit të BKT-së, nuk e ka verifikuar ngase ka menduar se çdo gjë është në rregull sepse është firma e S. dhe të njëjtin si çdo herë ia ka sjellë S.D, përfshirë edhe çmimin.

Dëshmitarja A.C. ndër të tjera ka deklaruar se nga viti 2008 punon në BKT (16 vjet), në vitin 2020 ka pasur cilësinë e menaxheres së operacioneve (punët operacionale, transferin, keshin e arkës etj.), duke iu përmbajtur plotësisht deklaratës që ka dhënë në polici. Lidhur me dokumentin e BKT-së, të datës 14 tetor 2020 (i cili i ishte prezantuar) ka theksuar se nënshkrimi ka qenë i saj dhe vula e bankës, mirëpo shuma prej 144 mijë e 363 euro, nuk ka qenë e saktë. Sipas qarkullimit ka pasur vetëm 4 mijë e 363 euro, kjo pjesa tjetër prej 144 mijë e lartë është e shtuar. Dokumenti është lëshuar nga ajo, por jo me shifrën e cekur prej 144 mijë e 363 euro, ndërsa në raport me pretendimin (e dhënë në polici) si vijon: *“dokumenti nuk është i lëshuar nga unë, sa i përket këtij dokumenti shihet se nënshkrimi ngjason me nënshkrimin tim, vula është e degës BKT Prizren dhe ju siguroj se dokumenti të cilin ju ma keni prezantuar nuk është lëshuar nga ana ime”*, ka theksuar se e vërteta është ajo që e ka thënë në polici. Nënshkrimi ngjason me nënshkrimin tim, vula është e bankës, mirëpo përmbajtja nuk është e saktë, duke mos iu kujtuar saktësisht se a e ka lëshuar e njëjta. Sa i përket dokumenteve për kompani janë marrë që të dy (S.D dhe A.D) mirëpo lidhur me këtë dokument nuk iu është kujtuar se cili mund t’u ketë kërkuar. Pas këtij rasti, S. ka qenë pas disa ditëve në bankë dhe i ka thënë se: *“për atë punën mos ke dert sepse ti nuk ke kurrfarë përgjegjësie”*. Sa i përket procedurave për t’u pajisur me një dokument zyrtar të bankës ka sqaruar se secili klient që ka të hapur një llogari në bankë ka të drejtë të kërkojë një dokument që quhet *“konfirmim”*, nuk ka ndonjë procedurë të veçantë mirëpo secili klient që ka llogari bankare të hapur ka të drejtë të paraqitet në bankë dhe të kërkojë qarkullimin bankar apo konfirmimin bankar. Sipas procedurave të brendshme të bankës, pos pronarit legjitim të llogarisë bankare të drejtë të ketë qasje në atë llogari bankare, ka personi tjetër i cili duhet të ketë autorizim të noterizuar dhe në rastin konkret me sa ishte kujtuar S.D dhe A.D nuk kanë pasur ndonjë person të tretë të autorizuar. Dokumentin *“konfirmim bankar”* të datës 14 tetor 2020, siç është nuk e ka e lëshuar e njëjta.

Procedimi i provave materiale

Në shqyrtimin gjyqësor janë administruar provat materiale si vijon: Dokumenti i falsifikuar i Bankës Kombëtare Tregtare me mbishkrimin “Confirmation” i datës 14 tetor 2020; Dokumenti i lëshuar nga BKT, i datës 11 maj 2022; Kontrata e lidhur mes kompanisë L.L.C me Agjencionin për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (shërbime të sigurimit fizik); Deklarata nën betim e datës 18.12.2020; Autorizimi për përfaqësime të kompanisë L.L.C; Referenca me subjektin N.T.P. “D....”, Referenca me subjektin “R....” SHA; Përgjigja nga ATK nr..... (Librat e shitjes 2018, 2019 dhe 2020); Kontrata lidhur mes kompanisë L.L.C me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (shërbime pastrimi); Deklarata nën betim; Referenca me subjektin N.T.P “D....”; Referenca me subjektin “R....” SH.A; Referenca me subjektin K.S “R.S. ”; Kontratat e lidhura mes kompanisë L.L.C me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (shërbime pastrimi); Deklarata nën betim; Referenca me subjektin N.T.P “D....”, Referenca me subjektin “R....” SHA, Referenca me subjektin K.S “R.S.”, të propozuara nga prokuroria, si dhe vula e firmës L.L.C, e propozuar nga mbrojtja e të akuzuarit S.D. avokat D.S.

Deklarimi i të akuzuarve

I akuzuari S.D gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale ka deklaruar si vijon: në muajin dhjetor të vitit 2015 e kam hapur biznesin “.. LLC”, në të cilin biznes kam qëndruar si pronar deri në vitin 2019 dhe më pas e kam transferuar te djali A.D (në muajin Maj apo Qershor). Arsyeja e transferimit të biznesit ka qenë sepse unë i kam pasur dy aktakuza të ngritura për shmangie nga tatimi ku jam shpallur i pafajshëm dhe një tjetër për vjedhje të energjisë elektrike dhe arsyeja tjetër ka qenë se nuk munda t’a marrë certifikatën për të kaluarën kriminale nga gjykata për t’u pajisur me licencë dhe për këto arsye i kam bartë në emër të djalit. Prej vitit 2015 e deri më sot unë menaxhoj në biznes, ndërsa djali vetëm formalisht është aksionar në biznes. Të gjitha kontratat të cilat janë lidhur me palët e treta i kam nënshkruar unë, po ashtu unë kam kontaktuar dhe kam përgatitur dosjet për të konkurruar për tender. Me biznes unë merrem prej pas luftës, edhe nëpër disa institucione private kam qenë Drejtor gjeneral dhe Drejtor financiar dhe ende sot i kemi katër ose pesë biznese, tre janë funksional, kurse dy janë duke pushuar mirëpo janë aktive – të regjistruara. Unë jam pronar, dhe dy djemtë A. dhe djali tjetër. Bizneset: “R.T. ” (fabrikë e vunicave) dhe N.T.P “D.C.” (fabrikë e peletit) jam unë

pronar, ndërsa në biznesin “R.S. ” (sigurim) pronar është djali A. Sa i përket dokumentit të lëshuar nga BKT, e kam pranuar unë personalisht përmes viber, ka qenë pandemi kam shkuar në bankë nga ora 10:30/h, jam afruar te dera (tek dëshmitarja A.) dhe i kam thënë se po më duhet një konfirmim për kompaninë, A. më tha se jam shumë e zënë me punë dhe a mund të vish nesër, i thash jo sepse më duhet t’a dorëzojë sot deri në fund të orarit të punës, A. më tha se do të mundohem deri në fund të orarit të punës t’a dërgoj në e-mail ose në viber dhe unë i thash në rregull. Kam pritur deri në ora 13:30/h dhe e kam thirrur në telefon A. e cila më tha se tani së shpejti do t’a dërgojë dhe më ka ardhur nga ora 13:45/h. Nga viber e kam transferuar në kompjuter dhe të njëjtin e kam printuar dhe ia kam dorëzuar dajës tim për t’ia bashkangjitur dokumentacionit të tenderit (të njëjtin e quan dokument të falsifikuar). Banka e posedon dokumentin - origjinalin, të cilin nuk ma ka dërguar fizikisht. Konfirmimi bankar ka pasur vlerë 144 mijë e 363 euro. Aplikimin e kam bërë në formë elektronike tek e-prokurimi. Sa i përket dokumentit të pranuar përmes viber nuk kam ndërhyrë aspak, nuk kam prekur asgjë. Kompania “...” LLC, ka qenë duke punuar me pastrim, dezinfektim dhe sigurim fizik, ndërsa nuk kam ditur saktësisht sa kam pasur qarkullim bankar, d.m.th. nuk e kam shikuar fare qarkullimin se sa ka qenë. Gjithë dokumentacionin e kam përgatitur unë, djali A. nuk ka të bëjë me këtë, po ashtu edhe deklaratat nën betim i kam nënshkruar unë (me vulë) sepse në atë kohë sa më kujtohet A. ka qenë në T... - student. Në raport me deklaratën e datës 18 dhjetor 2020 (deklarata nën betim), ka theksuar se vula është me nënshkrim të A., prandaj të gjitha veprimeve iu kam rënë me atë vulë (në të cilën është i deponuar nënshkrimi i A.). Vula është prej kohës kur është bërë A. pronar dhe prej atëherë nuk është ndërruar më. Ne kemi deponuar nënshkrimin në vulë sepse A. ka qenë student edhe më shumë ka qëndruar në T.. për shkak të studimeve dhe ne nuk e dimë se kur dalin tenderët e kur jo dhe nuk mund t’a thërras A.. nga S... për të më nënshkruar dhe vula na duhet jo vetëm për tenderë por edhe për dokumente të tjera. Meqenëse unë kam qenë si menaxher kryesor dhe i emëruar me autorizim por diku - diku kërkohej të jetë nënshkrimi i pronarit dhe atë vulë e unë e kam mbajtur gjithë në sirtar të mbyllur në zyrën time me çelës dhe unë e kam menaxhuar këtë vulë. Në kontratën datës 26 prill 2021 është nënshkrimi i A., ndërsa në deklaratën nën betim të datës 02 prill 2021 është i vulës me nënshkrim të A.. Sa i përket pretendimeve të dhëna në polici dhe prokurori, ku ka theksuar se : “*ndonjëherë kam nënshkruar unë e ndonjëherë A..*”, thekson se nuk ka nënshkruar A., por i njëjti i ka vulosur me vulë e në të cilën ka qenë i deponuar nënshkrimi i A.. Në raport me përgjegjësinë e A. në biznesin “...” LLC, i njëjti ka zero ndikim dhe zero përgjegjësi sa i përket menaxhimit të biznesit – të gjitha bizneseve, vetëm formalisht ekzistojnë në letër sepse unë jam pronari dhe përgjegjësi për të gjitha bizneset. Kur e kam transferuar firmën në emër të A. në të njëjtën kohë

kam bërë edhe autorizim gjeneral dhe në autorizim e kemi cekur që të gjithë barrën e mbajë unë edhe për të mirë edhe për të keq të menaxhimit të biznesit (data e autorizimit është 26.03.2021). Po ashtu kur kam hapur llogari kam qenë unë pronar dhe e kam hapur në emrin tim por në atë kohë i kam dhënë edhe A. autorizim për shkak se ndonjëherë ka mund që të mos jem prezent në K.. Në autorizimin e datës 21 qershor 2021, është nënshkrimi i A. D. (është gabim teknik) sepse A. nganjëherë e përdor “A.D. ” e ndonjëherë nënshkrimin që është nën emrin tim ngase unë e kam nënshkrimin pak më ndryshe – më të gjatë. Lidhur me këtë çështje kam dhënë deklaratë në polici dhe në prokurori dhe të njëjtave iu përmbahem.

I akuzuari A.D gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar si vijon: Në vitin 2019 apo në vitin 2020, jam bërë pronar i biznesit “... LLC”, ndërsa para kësaj periudhe pronar ka qenë babi dhe arsyeja pse më ka regjistruar mua ka qenë sepse nuk ka mundur që t’a nxjerrë një vërtetim të gjykatës. Biznesi “... LLC” merret me sigurim, pastrim dhe dezinfektim. Unë aty nuk kam pasur asnjë përgjegjësi, edhe pse kompania ka qenë në emrin tim dhe se unë në atë kohë kam qenë student në T... Nuk ka njohuri lidhur me ndonjë dokument – dosje për tender dhe nuk kam përgatitur asnjë dosje të tenderit. Nënshkrimi në vulë është i imi, si e kam bërë autorizimin babait, babai i ka pasur të gjitha të drejtat dhe e kam bërë edhe deponimin në atë vulë. Vula ka qëndruar në zyrën e babait dhe kur iu ka dashur që të nënshkruhen dokumentet, babai e ka përdorur dhe e përdorë ende. Lidhur me kontratat e fituara, tenderët i ka nënshkruar babai me vulë, unë me sa di nuk kam nënshkruar ndonjë kontratë apo deklaratë nën betim. Lidhur me dokumentin – kontratën e datës 17 maj 2021, është nënshkrimi im prej vulës. Po ashtu në deklaratën nën betim të datës 18 nëntor 2020 është nënshkrimi i vulës por unë ndonjëherë e bëjë “A.D.” e ndonjëherë e bëjë si nënshkrim. Lidhur me autorizimin e datës 26 mars 2012 (që i është dhënë në shikim) ku janë të vendosura dy nënshkrime ka theksuar se “A.D. ” është i imi nën emrin tim, ndërsa tjetri duhet të jetë ndonjë gabim teknik, por edhe ky është i imi. Në bankë për të marrë dokumente në emër të firmës “...” LLC, kam shkuar ndonjëherë kur babai nuk ka qenë në Kosovë për të bërë ndonjë pagesë, ndërsa për të marrë ndonjë konfirmim të bankës në BKT nuk kam qenë asnjëherë. Lidhur me rastin konkret u përmbahem deklaratave të dhëna në polici dhe prokurori.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare të parashtruar në formë të shkruar më 19 nëntor 2024, ndër të tjera ka theksuar se: është fakt i pakontestueshëm se të pandehurit A.D - Pronar i Kompanisë LLC në bashkëkryerje me të pandehurin S.D -Përfaqësues i kompanisë, me

vetëdije kanë shkelur rregullat e prokurimit publik duke paraqitur dokumentacion te rremë, në atë mënyrë që kanë përpiluar kontrata fiktive kinse të lidhura mes kompanisë L.L.C dhe kompanive “R....” SHA, N.T.P “D....”, dhe KS “R.S. ” të cilat i kanë paraqitur si referenca në dosjet e tenderëve në vitin 2021, të cilat referenca nuk janë fare të deklaruara në qarkullimin e Administratës Tatimore të Kosovës sipas procedurave fatura shitje-blerje dhe në Bankën Kombëtare Tregtare, si dhe kanë falsifikuar dokumentin e datës 14 tetor 2022 kinse të lëshuar nga BKT të cilin dokument e kanë përdorur në procesin e tenderimit, me ç’rast të njëjtit kanë vënë në lajthim autoritetet kontraktuese dhe kanë arritur që të nënshkruajnë tre kontratat me Institucionet e Republikës së Kosovës, dhe atë me datën 20 janar 2021 Operatori Ekonomik LLC ka lidhur kontratë me Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK) për “Sigurim Fizik për KM”, vlera e kontratës 18,000.00 (tetëmbëdhjetë mijë) euro, me datën 14 maj 2021 ka lidhur kontratë me Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për “Mirëmbajtja Higjienike” të objektit të sekretariatit të KGJK-së, në Graçanicë dhe Objektin e divizionit të Gjykatës së Apelit me seli në Mitrovicën e Veriut, vlera e kontratës 65,244.96 euro dhe më 26 prill 2021, ka lidhur kontratë me Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve për “Pastrimin dhe Mirëmbajtjen” e objektit në shfrytëzim nga MFPT, vlera e kontratës 11,149.92 euro. Në rastin konkret elementet e veprës penale Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik, janë konsumuar pasi që tani të akuzuarit S.D dhe A.D, kanë dorëzuar dokumentacionin për aplikim për tender, e në mesin e tyre, vërtetimin e falsifikuar nga BKT-ja si dhe kanë përpiluar kontrata fiktive, kinse të lidhura mes kompanive të lartcekura si referenca në dosjet e tenderëve në vitin 2021, të njëjtit e kanë bërë me dashje pasi që tani i akuzuari S.D, e ka ditur se sa ka qarkullim bankar në BKT, si dhe tani i akuzuari A.D e ka ditur se po nënshkruan deklaratë nën betim me dokumente të falsifikuara. Fakti se të pandehurit e kanë kryer këtë vepër penale është i pakontestueshëm, e kjo është provuar edhe nga deklaratat e dëshmitarëve si dhe nga provat të cilat janë prezantuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Nga deklarata e dëshmitarit M.H. gjatë këtij shqyrtimi është vërtetuar se çdo dokument për aplikim për tenderë e ka pranuar nga tani i akuzuari S.D edhe ato fizikisht dhe jo nëpërmes ndonjë aplikacioni, dhe pas kompletimit të dokumentacionit nga tani i akuzuari S.D, i njëjti i ka dorëzuar. Nga deklarata e dëshmitares A.C. është vërtetuar se dokumentin e BKT-së, të datës 14 tetor 2020, nuk e ka lëshuar ajo, pasi që e njëjta ka deklaruar se asnjëherë nuk e ka lëshuar një dokument të tillë me qarkullim bankar prej 144 mijë e 363 euro, pasi qarkullimi bankar i të akuzuarit ka qenë 4,363.00 euro, e njëjta deklaroi se pjesa prej 144 mijë e lartë, është e shtuar, po ashtu ka shtuar se me punë të kompanisë janë marrë që të dy të akuzuarit. Po ashtu e njëjta ka deklaruar se pas disa ditëve e ka takuar S. i cili i kishte thënë se për atë punë ti nuk ke

kurrfarë përgjegjësie. Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor janë prezantuar provat materiale të cilat janë administruar në rastin konkret. Nga dokumenti i lëshuar nga BKT, i datës 11 maj 2022 me të cilin e konfirmojnë nga Dega e BKT-së në P. se dokumenti “Confirmation” për ... LLC është vërtetuar se nuk është lëshuar nga BKT, pas verifikimeve në llogarinë e klientit “... LLC” qarkullimi deri me datë 14 tetor 2020 është 4,363.00 euro. Nga deklarata nën betim e datës 18 dhjetor 2020 është vërtetuar se e njëjta është nënshkruar nga i pandehuri A.D . Nga autorizimi i datës 26 mars 2021 shihet se i pandehuri A. D. e ka autorizuar të pandehurin S. që të mund të merr pjesë në çdo tender dhe se i ka të gjitha të drejtat mbi “... LLC”. Nga dokumentacioni është vërtetuar se referencat e njëjta janë përdorur për tre kontratat e lidhura të cekura si në dispozitiv të aktakuzës. Referenca me subjektin NTP “D...”, “R. ” dhe referenca me subjektin “R.S. ” janë të falsifikuara, fiktive, e kjo vërtetohet nga shënimi zyrtar i datës 27 prill 2022, me të cilin thuhet se kompania – subjekti “... LLC” , vlera e paraqitur në referencë prej 29,760 euro, për këtë periudhë kohore 01 janar 2018 – 31 dhjetor 2019, nuk është deklaruar fare në ATK. Gjithashtu edhe kontrata e lidhur në mes të “R.S. ” dhe “... LLC” vlera e shënuar në referencë prej 41,040.00 euro për datën 01 janar 2018 – 31 dhjetor 2018 nuk është deklaruar fare në ATK, si dhe kontrata e lidhur në mes të subjektit “R. ” SH.A dhe “... LLC”, vlera e kontratës 36,000.00 nuk është deklaruar në ATK. Gjithashtu thuhet se kompania “R. ” nga muaji 11, i vitit 2017 e ka ndërprerë deklarin, e kjo vërtetohet edhe nga përgjigja e ATK-së ... (librat e shitjes 2018, 2019 dhe 2020). Gjatë këtij shqyrtimi është prezantuar si provë edhe vula e cila e ka nënshkrimin e tani të akuzuarit A.D, me të cilën kanë pretenduar se është vulosur edhe deklarata nën betim për të cilën bëhet fjalë në aktakuzë, mirëpo edhe ky pretendim gjatë këtij shqyrtimi ka rënë poshtë pasi që është vërtetuar se deklarata nën betim dhe dokumenti për lidhje të kontratës për të cilën pretendonin se janë të vulosura me nënshkrimin e A. edhe vet i akuzuari e konfirmoi gjatë shqyrtimit se nënshkrimet nuk janë të njëjta. Gjatë këtij shqyrtimi janë deklaruar edhe të akuzuarit e lartcekur. Gjithashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor te akuzuarit A. i janë prezantuar dy dokumente me nënshkrimet e tij dhe i njëjti i gjendur para kësaj situate është deklaruar se nuk ka përgjigje pasi që në to vërehej qartë se njëri është i vulosur me vulë e tjetri është i nënshkruar nga vet i akuzuari. Andaj, kërkoj nga gjykata që mos t’ua falë besimin deklaratave të te akuzuarve, por të vendosë në bazë të provave dhe dëshmive të cilat janë prezantuar gjatë këtij shqyrtimi dhe të njëjtit të shpallen fajtorë, pasi që me administrimin e provave materiale është vërtetuar bindshëm se të akuzuarit A.D dhe S.D në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale që iu vihen në barrë. Lidhur me rrethanat rënduese të vërtetuara theksoj se si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin A.D të merret fakti se i njëjti nuk

ka të kaluar kriminale, ndërsa për të akuzuarin S.D nuk kemi gjetur rrethana lehtësuese. Me propozim që të njëjtit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.D, avokat D.S në fjalën përfundimtare të parashtruar në formë të shkruar me datë 20 nëntor 2024, ndër të tjera ka theksuar se: gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor dhe administrimit të provave personale dhe materiale, si dhe deklarimi i të akuzuarve, dëshmohet e faktohet se i akuzuari S.D, nuk është provuar se ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Nga dëshmia e dëshmitarit M.H., është arritur të dëshmohet e të kuptohet se i njëjti ka themeluar marrëdhënie pune me kompaninë LLC, që nga viti 2017. Prej asaj kohe dëshmitari ka punuar vetëm në këtë kompani në prokurim elektronik, edhe pse pozita e tij në këtë kompani sipas kontratës mbi punësimin ishte si menaxher i sigurimit fizik dhe se në këtë detyrë ishte ngarkuar nga i akuzuari S.D. Dëshmitari ka deklaruar se ai ka përgatitur listën e dokumenteve të kërkuara në dosje të tenderëve dhe atë listë ia ka dorëzuar të akuzuarit S.D dhe se ky i fundit e ka pajisur me të gjitha dokumentet e kërkuara. Lidhur me dokumentin me logo të bankës “BKT” me mbishkrimin “*Confirmation*” me vulë të BKT-së, të datës 14 tetor 2020, dokument që konfirmon qarkullimin e subjektit – kompanisë “...” LLC, dëshmitari kishte deklaruar se çdo dokument për aplikim për tender e ka pranuar nga i akuzuari S.D dhe se ai vetëm i ka sistemuar në formën elektronike të faqes E-prokurimi për aplikim për tender. Pra, nga dëshmia e dëshmitarit është arritur të vërtetohet se i njëjti ka punuar si Menaxher i Sigurimit Fizik, dhe se detyrë specifike e ka pasur futjen dhe radhitjen e të gjitha dokumenteve tenderuese në sistemin elektronik e-prokurimi dhe se të gjitha dokumentet i kishte pranuar nga i akuzuari S.D . Nga dëshmia e dëshmitares A.C. është arritur që të dëshmohet se lidhur me rastin e dokumentit me logo të BKT-së, me mbishkrimin “*Confirmation*”, e njëjta ka qenë konfuzë, ajo fillimisht ka deklaruar se i përmbahem tërësisht deklaratës së dhënë në polici ku kishte deklaruar se: *“dokumenti nuk është i lëshuar nga unë.. sa i përket këtij dokumenti shihet se nënshkrimi ngjason me nënshkrimin tim, vula është e degës BKT në Prizren dhe ju siguroj se dokumenti të cilin ju ma keni prezantuar nuk është lëshuar nga ana ime”* ndërsa gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor kishte deklaruar se ajo e kishte lëshuar këtë dokument dhe se nënshkrimi është i saj dhe vula është e bankës, mirëpo shifra, shuma prej 144 mijë e 363 euro, nuk është e saktë dhe me sa ka mbajtur mend sipas qarkullimit ka pasur vetëm 4 mijë e 363 euro. Po ashtu e njëjta ka shtuar se nuk i kujtohet se cili person ka shkruar t’u marrë dokumentin në fjalë. E njëjta nuk ka dhënë përgjigje të qartë si menaxhere operacionale në BKT, se çfarë procedure apo kushte ligjore duhet të përmbushen për t’u pajisur klientët e bankës me një dokument zyrtar, çfarë është dokumenti me mbishkrimin “*Confirmation*” me vulë të BKT-së, të datës 14

tetor 2020. Po ashtu nga dëshmia e dëshmitares nuk është arritur të kuptohet nëse e ka lëshuar dokumentin me logo të bankës “BKT” me mbishkrimin “*Confirmation*” me vulë të BKT-së, të datës 14 tetor 2020, nuk është arritur të kuptohet se nëse e ka lëshuar dokumentin me logo të bankës “BKT” me mbishkrimin “*Confirmation*” me vulë të BKT-së, të datës 14 tetor 2020, nuk është arritur të kuptohet se nëse është lëshuar nga cilido zyrtar i bankës me vlerën reale, se ku gjendet dokumenti burimor apo origjinal meqenëse këtë dokument e ka lëshuar Banka BKT, për çka Prokuroria Shtetit nuk ka arritur që t’u siguroj dokumentin se kush e lëshoj këtë dokument për çka kredibilitetin e këtij dokumenti e bënë të dyshimtë dhe jo bindës. Sa i përket pretendimit të Prokurorisë lidhur me shkeljen e rregullave të prokurimit publik duke paraqitur kinse dokumentacion të rreme, në atë mënyrë që kanë përpiluar kontrata fiktive të lidhura mes kompanisë L.L.C dhe kompanive “R....” SH.A, N.T.P “D....” dhe KS “R.S. ”, të cilat i kanë paraqitur si referenca në dosjet e tenderëve në vitin 2021 të cilat referenca nuk janë fare të deklaruara në qarkullimin e ATK-së, sipas procedurave fatura shitje-blerje, me asnjë provë të vetme apo thirrje ligjore konkrete nuk ka vërtetuar se i akuzuari S.D në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar të kompanisë L.L.C ka shkelur rregullat e prokurimit publik. Prokuroria në aktakuzën e saj askund nuk ka treguar se cila dispozitë e Ligjit mbi Prokurimin Publik apo Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat është shkelur nga i mbrojturi im S.D. Bizneset lartcekura janë biznese plotësisht legjitime të regjistruara në ARBK, dhe janë në pronësi të akuzuarit S.D apo familjarëve të ngushtë të tij dhe se kontratat e lidhura për shërbime të sigurimit fizik në mes të këtyre bizneseve nuk janë dokumente të rreme, e as kontrata fiktive sepse këto biznese të cekura më lartë punojnë dhe në veprimtarinë e tyre biznesore ofrojnë kryesisht shërbime të sigurimit fizik, shërbime përcjellëse të kësaj natyre dhe të cilat kanë një përputhje edhe me objektin kontratave të cilat janë lidhur në mes vete. I akuzuari S.D në cilësinë e përfaqësuesit të biznesit “....” L.L.C gjatë aplikimit në procedurat tenderuese ka fituar tri kontrata me Institucionet e Republikës së Kosovës, të cilat janë edhe objekt i kësaj akuze dhe atë: a) Më 14 maj 2021 ka lidhur kontratë me AK, Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovë me titull “Mirëmbajtja Higjienike” e objektit të sekretariatit të KGJK-së, Graçanicë dhe Objektin e divizionit të Gjykatës së Apelit me seli në Mitrovicën e Veriut, vlera e kontratës 65,244.96 euro. Në këtë dosje tenderuese në faqen 14, pika 9.1 dhe 9.2 lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Autoriteti Kontraktues ka kërkuar si dëshmi të dokumentuar: Lista e kontratave të realizuara së bashku me referenca apo raport të pranimit; b) Po ashtu më 20 janar 2021 Operatori Ekonomik LLC ka lidhur kontratë me Autoritetin Kontraktues, Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK) me titull “Sigurimi Fizik për KM”, vlera e kontratës 18,000.00 euro. Në

këtë dosje tenderues në faqen 14, pika 9.1 dhe 9.2 lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Autoriteti Kontraktues ka kërkuar si dëshmi të dokumentuar: Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Listës duhet t'i bashkëngjiten dëshmi kopjet e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat dhe projektet e cekura në listë, me numër të prokurimit apo numër të kontratës dhe datën e tyre (kopje); c) Edhe me datën 26 prill 2021 është lidhur kontratë me Autoritetin Kontraktues, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me titull "Pastrimi dhe Mirëmbajtja e objektit në shfrytëzim nga MFPT", vlera e kontratës 11,149.92 euro. Po ashtu edhe në këtë dosje tenderuese, faqe 16, pika 9.1 dhe 9.2 kërkohet në kuadër të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkohet: vitet e shkuara nga njoftimi për kontratë për shërbime të natyrës lëndë e së cilës është ky aktivitet, dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatave të pranimeve në tri vitet e shkuara duke saktësuar - shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Pra, në të gjitha rastet biznesi L.L.C gjatë aplikimit në procedurat tenderuese ka fituar tri kontrata me Institucionet e lartcekura dhe në asnjë rast nuk janë shkelur rregullat e prokurimit publik, e po ashtu nuk është kërkuar që këto kontrata dhe referenca të deklarohen në ATK nga fakti se nuk ka asnjë dispozitë ligjore ku kërkohet që referencat apo kontratat të deklarohen në ATK. Prandaj me asnjë provë të vetme nuk mund të vërtetohet se i akuzuari S.D në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar të kompanisë L.L.C ka shkelur rregullat e prokurimit publik apo ka lidhur kontrata fiktive sepse këto pretendime nuk qëndrojnë siç u dëshmuar si më lartë, pasi që gjatë aplikimit në dosjet tenderuese I akuzuari ka ofruar kontratat dhe referencat ashtu siç janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Gjatë dëshmisë së të akuzuarit S.D është vërtetuar se i njëjti ka hapur biznesin e tij në dhjetor të vitit 2015, si pronar dhe ka vazhduar deri në vitin 2019, ndërsa arsyeja se pse e ka transferuar biznesin te djali i tij A.D ishte sepse nuk kishte mundësi të merr certifikatë mbi të kaluarën e tij kriminale në gjykatë dhe se pengohej të aplikon për tendere nëpër Institucione Publike. Pas vitit 2019 i akuzuari S. e menaxhon tërësisht biznesin LLC, sipas autorizimit të dhënë duke nënshkruar të gjitha kontratat biznesore, gjithë dokumentacionin tenderues. I akuzuari S.D ka deklaruar se aplikimin për në dosjen tenderuese e ka bërë ashtu siç edhe e ka pranuar dokumentin nga Banka BKT. I njëjti po ashtu ka deklaruar se të gjitha kontrata tenderuese dhe deklaratat nën Betim i ka nënshkruar vetë ose me vulën - nënshkrimin e djalit të tij të akuzuarit A.D edhe pse në ndonjë deklaratë ka nënshkruar por pa e ditur fare dhe pa qenë i përfshirë në menaxhimin e Biznesit, ky fakt vërtetohet edhe me moshën e tij, pa përvojë në punët e menaxhimit të biznesit (duke qenë student në T.). Prandaj duke i marrë parasysh të gjitha faktet si tërësi nga kjo lëndë penale vëmë

në përfundim se mungojnë tërësisht elementet e veprës penale në fjalë dhe kërkojmë nga Gjykata që të sjellë aktgjykim lirues për të mbrojturin tim S.D.

I akuzuari S.D në fjalën përfundimtare ka deklaruar si vijon: e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe dua të shtoj se pretendimet e prokurorisë dhe akuza e prokurorisë është e pa bazuar dhe prokuroria nuk ka mundur që të siguroj kurrfarë fakte ose dëshmi për gjykatën, vetëm me një letër - kopje në atë po bazohet se unë kam falsifikuar, por nuk ka “dashur” që të vërtetojë faktin se a ka mundur të jetë si gabim teknik i bankës – nga vet banka sepse ka qenë pandemi dhe kërkojë nga gjykata pasi që nuk ka prova të mjaftueshme dhe duke marrë parasysh dëshmitaren e bankës dhe konkurrenti im – një kompani tjetër ka vënë në lajthim prokurorinë dhe nga të gjitha këto kërkoj nga gjykata që të më liroj mua dhe djalin nga aktakuza sepse aspak nuk ndihemi fajtor.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.D, avokat V.O në fjalën përfundimtare të parashtruar në formë të shkruar më 21 nëntor 2024, ndër të tjera ka theksuar gjatë procedurës së administrimit të provave në këtë çështje penale dhe atë administrimi i provave personale dhe materiale, mbrojtjen e dhënë nga dy të akuzuarit, nuk është arritur të vërtetohen faktet përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari A.D ka kryer veprën penale për të cilën edhe akuzohet. Para se gjithash përshkrimi faktik i veprimeve të të akuzuarit A.D sipas aktakuzës nuk përfshin kohën e kryerjes si element qenësor i veprës penale dhe në mungesë të këtij elementi nuk mund të ketë veprë penale dhe përgjegjësi penale ndaj të akuzuarit. Nga dispozitivi i aktakuzës së Prokurorisë nuk ka palë të dëmtuar, andaj në mungesë të palës së dëmtuar nuk mund të ketë veprë penale ku me veprimet e të akuzuarit do të ishte shkaktuar ndonjë dëm palës apo institucionit të caktuar. Fakt i pakontestueshëm në këtë çështje penale është se i akuzuari A.D është pronar i subjektit L.L.C, bazuar në ndryshimet statutare të bëra në këtë subjekt në vitin 2020 ku edhe tani i akuzuari A.D formalisht është pronar i këtij subjekti. Edhe përkundër ndryshimeve statutare në këtë subjekt me dëgjimin e dëshmitarit M.H. i punësuar në këtë subjekt si person përgjegjës për të ndërmarrë veprimet për aplikim ku subjekti L.L.C është paraqitur si Operator Ekonomik, ka dëshmuar faktin se të gjitha veprimet në emër të subjektit dhe përgatitja e gjithë dokumentacionit është bërë nga i akuzuari S.D duke përfshirë edhe procedurat e prokurimit, ku pretendohet se janë përdorur dokumente jo të sakta. Edhe dëshmitarja - zyrtarja në bankën BKT ka dëshmuar se S.D e ka pranuar konfirmimin mbi qarkullimin bankar të këtij subjekti. Gjykata do të kishte vërtetuar një gjendje të plotë faktike lidhur me pa përgjegjësinë e të akuzuarit A.D po të kishte aprovuar propozimin e mbrojtësit

të te akuzuarit të propozuar në seancën e datës 10 tetor 2024 për të kërkuar nga BKT kontratën për hapjen e llogarisë si dhe veprimet operative në këtë llogari sidomos në periudhën kur pretendohet se është kryer vepra penale. Prokuroria pretendon të vërtetojë gjendjen faktike se i pandehuri A. D. nuk ka deklaruar fare në ATK qarkullimin sipas kontratave mbi shërbimet të paraqitura si në dispozitiv të aktakuzës sipas procedurave faturave – shitje – blerje duke konstatuar se si pasojë e mos deklarimit të tyre në AKT kontratat e paraqitura si referenca në procedurën e prokurimit janë fatura fiktive. Para se gjithash këto veprime nuk përbëjnë figurën dhe elementet esenciale të veprës penale për të cilën i akuzuari A.D akuzohet. Kontratat e paraqitura si referencë para se gjithash janë kontrata të lidhura në mes të subjekteve të pavarura dhe kanë forcën ligjore të një pune juridike të vlefshme me ç’rast në mes të palëve kanë krijuar të drejta dhe obligime të cilat edhe janë përmbushur në mes tyre. Mos paraqitja e faturave në ATK si qarkullim i shitjes dhe blerjes nuk janë elemente ligjore që përcaktojnë se një kontratë a është fiktive apo jo, por mund të jenë elemente të përgjegjësisë së shmangies tatimore e në asnjë rrethanë ligjore nuk i bënë këto kontrata fiktive në kuptim të LMD-së. Bazuar në LMD, neni 50 ka përcaktuar se kontrata e cila e fsheh një kontratë tjetër konsiderohet se është kontratë fiktive, në rastin konkret kontratat e lidhura në mes të subjekteve që janë paraqitur si kontratë referuese në dosjen tenderuese nuk kanë të bëjnë me fshehjen e një pune tjetër juridike. Pretendimi i Prokurorisë se i akuzuari A.D ka falsifikuar edhe dokumentin e lëshuar nga BKT, të datës 14 tetor 2022, i cili dokument po ashtu është shfrytëzuar në procedurën tenderuese, nga provat e administruara përkatësisht dëgjimin e dëshmitarit M.H dhe zyrtaren e bankës, është vërtetuar fakti se i akuzuari A.D nuk ka pasur njohuri në përgatitjen e këtij tenderi në aspektin e sigurimit të dokumentacioneve, e aq më pak të nxjerrjes së saj nga banka. Se ky dokument pretendohet se është i falsifikuar, nuk është vërtetuar me asnjë ekspertizë grafologjike, ndërsa po ashtu mbetet e pa vërtetuar edhe vërtetësia e këtij dokumenti në mungesë të origjinalit të saj. Procedurat e prokurimit ku Prokuroria pretendon se janë mbështetur në dokumente të falsifikuara të lidhur në mes të subjektit L.L.C dhe Institucioneve të Republikës së Kosovës, janë lidhur pas një vlerësimi të procedurës së prokurimit e cila ka kaluar të gjitha procedurat e parapara ligjore dhe si të tilla janë nënshkruar pas kalimit të të gjitha fazave të ankimimit edhe nga Operatorët e tjerë ekonomik. Kontratat me institucionet shtetërore të lartcekura janë ende në zbatim, duke i bërë kontratat të vlefshme me efekt juridik në mes të subjekteve nënshkruese. I akuzuari A.D gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me veprimet dhe përgjegjësitë e tij në subjektin LLC, ka deklaruar se vetëm formalisht është përfshirë si pronar i këtij subjekti, e këtë për shkak të sigurimit të licencave të punës, pasi që i akuzuari S.D, nuk ka mundur t’i sigurojë për shkak të zhvillimit të disa

çështjeve penale ndaj tij. I njëjti ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë përgjegjësi në vendimmarrje apo në aktivitetin e këtij subjekti pasi që në atë periudhë kishte qenë student. Gjykata, deklaratës së të akuzuarit A.D, duhet të ia falë besimin e plotë, pasi që e njëjta është në përputhje të plotë edhe me të gjitha provat materiale të administruara dhe dëshmitarëve të cilët janë dëgjuar në këtë proces gjyqësor. Me asnjë provë të administruar nuk është provuar elementi subjektiv i veprës penale përkatësisht qëllimi i të akuzuarit A.D se ka ndërmarrë ndonjë veprim që do të kishte element të veprës penale. Evidentimi formal i tij në ARBK si pronar i Subjektit L.L.C dhe mos ndërmarrja e asnjë veprimi lidhur me menaxhimin e subjektit nuk e bënë të jetë penalisht përgjegjës edhe për veprimet e personave të tjerë pasi që përgjegjësia është individuale. Andaj, mbi bazën e të lartcekurave propozoj që në kuptim të nenit 363 paragrafi 3 të KPPK-së, i akuzuari A.D të lirohet nga aktakuza në mungesë të te provuarit se i njëjti ka kryer veprën penale në fjalë.

I akuzuari A.D në fjalën përfundimtare ka deklaruar si vijon e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam asgjë për të shtuar.

VLERËSIMI I PROVAVE

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, në vijim do të vlerësoj secilën provë veç e veç dhe do nxjerr përfundimet për çështjet dhe faktet që i ka vërtetuar gjatë shqyrtimeve gjyqësore. Me qëllim të krijimit të një pasqyre të plotë lidhur me rastin konkret, gjatë analizimit të deklaratave dhe administrimit të të gjitha provave e njëjta do të fokusohet në detaje dhe rrethana të cilat ndriçojnë objektin e çështjes penale konkrete.

Rrethanat jokontestuese

Në këtë çështje penale nuk ka qenë kontestues fakti se i akuzuari S.D me biznes është marrë që nga periudha e pas luftës, ku edhe tani ka disa biznese, prej të cilave tre (3) janë funksional, kurse dy (2) biznese kanë duke pushuar, mirëpo janë aktive – të regjistruara. Tek bizneset në fjalë i njëjti është pronar, si dhe dy djemtë e tij. Bizneset si: “R...” (fabrikë e vunicave) dhe N.T.P “D.C.” (fabrikë e peletit) është pronar i akuzuari S.D, ndërsa në biznesin “R.S. ” (sigurim) pronar është djali i tij – i akuzuari A.D . Nuk ishte kontestues as fakti se biznesin e tij LLC, e kishte hapur në vitin 2015, si pronar – drejtor i biznesit, në të cilin ka qëndruar deri në vitin 2019, ndërsa pas kësaj periudhe (Maj – Qershor 2019) biznesi i tij ka kaluar në

emër të djalit të tij – të akuzuarit A.D, i cili vetëm formalisht kishte figuruar si aksionar dhe se i gjithë menaxhimi i biznesit të lartcekur ishte bërë nga i akuzuari S.D. Po ashtu në këtë çështje penale nuk ka qenë kontestuese rrethana se Operatori Ekonomik LLC ka nënshkruar tre (3) kontrata me Institucionet e Republikës së Kosovës dhe atë: 1. Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës; 2. Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe 3. Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve.

Rrethanat kontestuese

Kontestuese në këtë çështje penale mbetet rrethana nëse të akuzuarit e lartcekur kanë shkelur rregullat e prokurimit publik, duke paraqitur dokumentacion të rremë, përkatësisht dokumentin e lëshuar nga BKT, datë 14 tetor 2024 dhe sipas të njëjtit dokument të kenë përpiluar kontrata fiktive të lidhura mes kompanive (të ndryshme) që të njëjtit janë pronar, e të cilat janë paraqitur në dosjet e tenderëve gjatë vitit 2021, sipas të cilave kanë lidhur kontratat përkatëse me Institucionet Publike të Republikës së Kosovës.

Nga dëshmia e dëshmitarit M.H. gjykata ka arritur të provoj faktin se i akuzuari S.D ka qenë pronar i kompanisë LLC, në të cilën kompani dëshmitari ka filluar punën nga viti 2017, ku sipas kontratës së punës i njëjti kishte cilësinë si menaxher i sigurimit fizik, ndërsa detyra e tij ka qenë të merret me prokurim elektronik, në të cilën detyrë ishte ngarkuar nga S.D, të cilit i ishte përgjigjur lidhur me punën. Sa i përket dosjeve për tenderë i njëjti ka përgatitur listën e dokumenteve, të cilat dokumente i janë siguruar nga i akuzuari S.D, të vulosura nga i njëjti, të cilat dëshmitari i ka skenuar dhe i ka dorëzuar për tender (në mënyrë elektronike). Sistemi E-prokurimi ka figuron në emër të të akuzuarit S., ndërsa dëshmitari me leje nga i njëjti, ka hyrë në sistem dhe ka ndërmarrë veprime të caktuara dhe se për secilin njoftim nga autoritetet kontraktuese e ka njoftuar të akuzuarin e lartcekur. Sa i përket dokumentit të BKT-së, nuk ka bërë ndonjë verifikim ngase ka menduar se çdo gjë është në rregull, ngase firma ka qenë e S. Po ashtu në raport me të akuzuarin A.D, me të njëjtin nuk ka pasur kurrfarë kontakti lidhur me detyrën që e ka bërë në kompani. Deklarata e këtillë për gjykatën ka qenë e besueshme, ka përkuar me provat që janë në shkresat e lëndës, të njëjtën e ka trajtuar si relevante për çështjen penale konkrete duke provuar disa fakte me rëndësi për trajtimin e rastit, përkatësisht detyrat dhe përgjegjësitë e tij në kompani, të të akuzuarve, për çka edhe ia ka falur besimin.

Nga dëshmia e dëshmitares A.C. gjykata ka provuar faktin se e njëjta në cilësinë e menaxheres së operacioneve në BKT, ka qenë në marrëdhënie pune edhe gjatë vitit 2020. Në raport me dokumentin e BKT-së, i datës 14 tetor 2020, nënshkrimi ka qenë i saj si dhe vula e bankës BKT, mirëpo shifra – shuma prej 144 mijë e 363 euro, nuk kishte qenë e saktë, ngase sipas qarkullimit ka pasur vetëm 4 mijë e 363 euro dhe pjesa tjetër prej 144 mijë e lartë ishte e shtuar. Sa i përket dokumentit me emrin “*konfirmim*” një dokument të këtillë ka të drejtë t’ a kërkojë secili klient që ka të hapur një llogari në bankë dhe sipas procedurave të brendshme të bankës pos pronarit legjitim të llogarisë bankare, të drejtë të ketë qasje në atë llogari bankare, ka personi tjetër i cili duhet të ketë autorizim të noterizuar dhe në rastin konkret të akuzuarit S.D dhe A.D nuk kanë pasur ndonjë person të tretë të autorizuar. Dokumenti “*konfirmim bankar*” i datës 14 tetor 2020 (siç i është prezantuar) nuk është lëshuar nga e njëjta. Kjo gjykatë deklaratën e dëshmitares e ka cilësuar mjaft relevante lidhur me rastin konkret, nga e cila ka provuar faktin se i akuzuari S.D, ka bërë falsifikim të dokumentit, meqenëse një dokument i këtillë nuk është lëshuar nga zyrtarja – dëshmitarja në kuadër të detyrave të punës. Të njëjtës deklaratë ia ka falur besimin duke e cilësuar si reale, ishte e njëjtë me deklaratën e dhënë në stadin e parë të kësaj procedure penale dhe përkonte me gjendjen faktike, përkatësisht provat e administruara.

Nga Dokumenti i falsifikuar i Bankës Kombëtare Tregtare me mbishkrimin “*Confirmation*” datës 14 tetor 2020 – në gjuhën angleze, vërtetohet rrethana se personi i lartpërmendur – Klienti L.L.C, me nr. unik ... me adresë: RR. nr. P...., me nr. të account, është klient i BKT – Dega në Sh... dhe llogaria e tij e biznesit nga data 08 nëntor 2019, ka bërë qarkullim prej 144,363.00 euro, e që vërtetohet fakti se gjendja e qarkullimit bankar në periudhën e lartcekur nuk është saktë, për shkak se gjatë kësaj periudhe kjo kompani ka pasur qarkullim bankar në shumë prej 4,363.00 euro, e konfirmuar nga banka BKT.

Nga Dokumenti i lëshuar nga BKT i datës 11 maj 2022 gjykata ka vërtetuar faktin se Banka Kombëtare Tregtare Kosovë – Sh.A, me 11 Maj 2022, ka dërguar përgjigje në kërkesë të datës 10 maj 2022 – Policisë së Kosovës, me anë të së cilës e ka njoftuar institucionin se Dokumenti “*Confirmation*” me të dhënat: Klienti L.L.C, me nr. unik, me adresë: Rr., Account, nuk është lëshuar nga BKT. Si dhe sipas verifikimeve të bëra nga zyrtarët kompetent të BKT-së, në gjendjen e llogarisë së klientit L.L.C, me nr. të Account, ju konfirmojmë se qarkullimi deri më 14 tetor 2020 është 4,363.00 euro dhe data e hapjes së llogarisë është 14 maj 2020. Me këtë provë gjykata vërteton faktin se dokumentin “*Confirmation*” nuk e ka

lëshuar banka, nga rezulton se i njëjti është i falsifikuar dhe me anë të së cilit i akuzuari ka vënë në lajthim institucionet kompetente duke prezantuar dokument të rremë gjatë procedurës së prokurimit publik, se kinse i njëjti ka qarkullim bankar në vlerë prej 144,363.00 euro dhe me rastin konkret ka arritur që të nënshkruaj tre kontratat me Institucionet Publike të Republikës së Kosovës.

Nga Kontrata e lidhur mes kompanisë L.L.C me Agjencionin për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (shërbime të sigurimit fizik), provohet fakti se Biznesi në emër të akuzuarit A.D , me Agjencionin e lartcekur me datë 20 janar 2021, kanë lidhur kontratë publike: “Sigurimi Fizik” për KM. Beteja e Koshares – Koshare me nr. të prokurimit: (elektronike), çmimi i shërbimeve 18,000.00 (tetëmbëdhjetë mijë) euro, për çdo muaj 1,500.00 (një mijë e pesëqind) euro.

Me Deklaratën nën betim e datës 18 dhjetor 2020, provohet se përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik, i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në procedurë të tenderimit dhe se pranon mundësinë e sanksionimit (penale apo civile) në rast se dorëzon dokumente jo valide, e cila deklaratë përmban të dhënat e të akuzuarit A.D dhe e nënshkruar nga po i njëjti, që përmban nënshkrimin identik (si nënshkrimi i vendosur në vulë), e që është deponuar si provë materiale në shqyrtim gjyqësor.

Autorizimi për përfaqësime të kompanisë L.L.C, i datës 26 mars 2024, vërteton rrethanën se Pronari i kompanisë së lartcekur A.D, e ka autorizuar S.D , si Drejtor i Kompanisë, që mund të merr pjesë në çdo tender, mund të nënshkruaj në emër të tij (A.D) dhe në emër të kompanisë, të merr pjesë në mbledhje dhe të përfaqësoj Kompaninë L.L.C, të e drejtoj, menaxhoj kompaninë, si dhe posedon të gjitha të drejtat tjera mbi kompaninë L.L.C. Autorizimi në fjalë është nënshkruar nga të dy palët, këtu të akuzuarit A.D dhe S.D .

Nga Referenca me subjektin N.T.P “D...”, datë 10 janar 2020, rezulton se fabrika e këpucëve “D...” ka nënshkruar kontratë me OE L.L.C - S.D dhe vlera e realizuar pas 24 muajve nga data 01 janar 2018, deri me datën 31 dhjetor 2019, ka arritur vlerën prej 36,000.00 (tridhjetë e gjashtë mijë) euro.

Nga Referenca me subjektin “R...” SHA, datë 07 shkurt 2020, rezulton se subjekti në fjalë ka nënshkruar kontratë me OE L.L.C dhe vlera totale e kësaj kontrate për periudhën një vjeçare

01 janar 2019, deri më 31 janar 2020, ka arritur vlerën prej 36,000.00 (tridhjetë e gjashtë mijë) euro.

Me përgjigjen e ATK nr.... (Librat e shitjes 2018, 2019 dhe 2020), gjykata ka vërtetuar faktin se S.D, është aksionar – pronar në këto biznese: 1. KS “R.S.” –; 2. ...LLC –; 3. S. D. – NTP D....8 ...dhe 4. R.... SHA-..... Biznesi .. LLC në periudhën 2018 – 2020 ka pasur qarkullim 95,289.48 euro, ndërsa totali i kontratave të paraqitura në aplikacion për tender kapin shumën prej 111,563.00 euro. Biznesi “R....” ka ndërprerë deklarinimin që nga data 11/2017, ndërsa ka pasur këto transaksione kontratë në shumën prej 36,000.00 euro, si dhe ka pasur të hyra nga thesari i Kosovës – përmes Komunës – K., fatura, shuma e arkëtuar 2850.00, data 18 mars 2020 (thesari), po ashtu ka pasur të hyra nga e njëjta – fatura shuma e arkëtuar 127,12 data 18 mars 2020 (thesari). Nga thesari ka një e hyrë nga Komuna e Prizrenit 28 gusht 2020, shuma 893,00 euro. Për vitin 2020 ka të hyra nga KK K.. në shumë prej 3,363.00 euro, por me biznesin KS ... SH.P.K (Dr. ...L.L.C) ..., data 03 prill 2020 (thesari). Instituti – Faturat, të gjitha kanë datën 25.07.2020 shuma totale e tre faturave 508,48 euro. Instituti Faturat ... shuma 21,19 euro, datë 08 shtator 2020. Në banka ka transaksione vetëm në BKT (deri në 06/2021). Raportit i ka bashkangjitur librat e shitjes për vitet 2018-2020.

Nga Kontratë e lidhur mes kompanisë L.L.C me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (shërbime pastrimi), vërtetohet fakti se palët kontraktuese kanë nënshkruar kontratën publike kornizë : Mirëmbajtja higjienike e Objektivit të Sekretariatit të KGJK-së, Graçanicë dhe objektin e divizionit të gjykatës së Apelit me seli në Mitrovicën e Veriut, me numër identifikues :dhe numër i brendshëm i prokurimit, me vlerë totale indikative 65,244.96 euro.

Nga Deklarata nën betim, e datës 02 prill 2021, rezulton se përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik L.L.C - S.D – Drejtor, i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në procedurë të tenderimit dhe se pranon mundësinë e sanksionimit (penale apo civile) në rast se dorëzon dokumente jo valide, e cila deklaratë përmban të dhënat e të akuzuarit S.D – Drejtor, e nënshkruar me të po njëjtën vulë – nënshkrim sikurse të deklaratë në emër të A.D. Nga kjo provohet fakti se vula ka pasur të vendosur nënshkrimin e të akuzuarit A.D, e cila edhe është përdorur në dokumentet e biznesit L.L.C.

Nga Referenca me subjektin “R....” SHA, më 07 shkurt 2020, rezulton se subjekti ka nënshkruar kontratë me OE L.L.C, me titull: Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit në D...,

vlera totale e kontratës për periudhën dy vjeçare (01 shkurt 2018, deri më 31 janar 2020) ishte 36,000.00 euro.

Nga Referenca me subjektin KS “R.S. ”, e datës 30 janar 2021, rezulton se kompania në fjalë ka nënshkruar kontratë me OE L.L.C, titulli i kontratës: Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të “R.S. ” – Prizren, zgjatja e kontratës: 01 janar 2018 - 31 dhjetor 2020.

Nga Kontratë e lidhur mes kompanisë L.L.C me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (shërbime pastrimi), është vërtetuar fakti se Kompania në fjalë më 26 prill 2021, kanë lidhur kontratë publike: Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit në shfrytëzim nga MFPT, me vlerë totale për 12 muaj – 11,149.92 euro.

Sa i përket provave: 1. Deklarata nën betim, e datës 02 prill 2021; 2. Referenca me subjektin N.T.P “D....”; 3. Referenca me subjektin “R...” SHA; 3. Referenca me subjektin KS “R.S.”, e datës 13 janar 2021, si dhe Përgjigja nga ATK nr..... (Librat e shitjes 2018, 2019 dhe 2020), kanë përmbajtje identike me provat të cilat e sipër elaboruara.

Nga shkresa, e cila përmban vulën e kompanisë L.L.C, provohet se në të njëjtën është vendosur nënshkrimi i të akuzuarit A.D .

Elementet e veprës penale

Gjykata me vëmendje ka analizuar dispozitën ligjore nga neni 415 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 të KPRK-së, më të cilën dispozitë është përcaktuar se formën themelore të veprës penale *Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik* e kryen: “*Kushdo që me vetëdije shkel rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për dhënien e kontratës së prokurimit publik, duke paraqitur dokumentacion të rremë, marrëveshje të fshehtë kundërligjore apo ndërmerr ndonjë veprim tjetër të paligjshëm me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik dhe me qëllim të ndikimit në vendimin e një autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit publik, dënohet me gjobë dhe burgim deri në pesë (5) vjet ... Nëse kryerësit e veprave penale nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, përfitojnë ose shkaktojnë dëme të konsiderueshme pasurore, në vlerat mbi pesëmijë euro (5.000), atëherë kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet*”.

Gjendja faktike e vërtetuar në raport me të akuzuarin S.D

Gjykata pas administrimit të të gjitha provave personale dhe materiale vlerësimit me ndërgjegje të secilës provë një nga një dhe në lidhje reciproke me njëra - tjetrën, konform nenit 360 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se me veprimet e të akuzuarit S.D konsumohen elementet e veprës penale Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik nga neni 415 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 të KPRK-së. Në rastin konkret gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari S.D - Përfaqësues i kompanisë LLC, të cilën kompani i njëjti e kishte themeluar në vitin 2015, mirëpo për shkak se kishte probleme me ligjin, fakt i cili është provuar nga Sistemi i evidencës penale, nga figuron se i njëjti ka 20 aktgjykime dënuese të formës së prerë (për vepra të ndryshme penale) biznesin në fjalë e ka kaluar në emër të djalit të tij A.D. Përkundër se biznesi ka kaluar në emër të djalit të tij, i akuzuari S.D ka menaxhuar tërë biznesin në fjalë si pronar, fakt i cili është provuar me deklaratën e dëshmitarit M.H., i cili ndër të tjera ka theksuar se mua më punë më ka punësuar S.D dhe se për punën që unë e kryejë në kompani i përgjigjem vetëm të akuzuarit S.D. Po ashtu i gjithë dokumentacioni i cili më nevojitet për të aplikuar për tender, më vie i gatshëm (i pagatitur dhe i vulosur) nga S.D.

Andaj, i akuzuari i sipër shënuar si përfaqësues i kompanisë, me vetëdije ka shkelur rregullat e prokurimit publik duke paraqitur dokumentacion të rremë, përkatësisht i njëjti ka falsifikuar dokumentin e datës 14 tetor 2022 kinse ai dokument është lëshuar nga BKT, të cilin e ka përdorur në procesin e tenderimit. Krahas dokumentit të rremë të lëshuar nga BKT, dokumentacioni i përgatitur për proces nuk ka qenë i saktë, sepse bazuar në Letrën rekomanduese – referencë, e datës 10 janar 2020, e administruar si provë në këtë çështje penale, rezulton se *Fabrika e këpucëve* N.T.P “D....”, ka nënshkruar kontratë me Operatorin Ekonomik L.L.C, për pastrimin dhe mirëmbajtjen e objektit të fabrikës së lartcekur, në vlerën e lartshënuar, sipas dokumentit figuron emri i të akuzuarit S.D, pa ndonjë cilësi, në anën tjetër i akuzuari gjatë këtij procesi ka theksuar se posedon disa biznese në vijim: “*Bizneset: “R.T. ” (fabrikë e vunicave) dhe N.T.P “D....” (fabrikë e peletit) jam unë pronar, ndërsa në biznesin K.S “R.S. ” (sigurim) pronar është djali A.*”, tani lind pyetja se biznesi (N.T.P “D....”) është fabrikë e këpucëve apo fabrikë e peletit dhe si është e mundur që një person të lidhë kontrata me bizneset e tij, ku i njëjti është pronar, marrë parasysh se cilësia e palëve kontraktuese është e përcaktuar me dispozita ligjore.

Se kontratat kanë qenë fiktive vërtetohet edhe nga përgjigja ATK-së, e datës 26 prill 2022, e administruar si provë më sipër, nga e cila provohet se i akuzuari fare nuk ka të deklaruar qarkullim sipas procedurave shitje – blerje. Andaj, referuar të lartcekurave i akuzuari S.D ka vënë në lajthim autoritetet kontraktuese, duke iu prezantuar dokumentacione të rreme dhe ka arritur që të nënshkruajnë tre kontratat me Institucionet e Republikës së Kosovës, dhe atë më 20 janar 2021 Operatori Ekonomik LLC ka lidhur kontratë me Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK) për “Sigurim Fizik për KM”, vlera e kontratës 18,000.00 (tetëmbëdhjetë mijë) euro, më 14 maj 2021 ka lidhur kontratë me Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për “Mirëmbajtjen Higjienike” të objektit të sekretariatit të KGJK-së në G.. dhe Objektin e Divizionit të Gjykatës së Apelit me seli në M...e V..., vlera e kontratës 65,244.96 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e katër dhjetë e katër euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent) si dhe më 26 prill 2021, ka lidhur kontratë me Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve për “Pastrimin dhe Mirëmbajtjen” e objektit në shfrytëzim nga “MFPT”, vlera e kontratës 11,149.92 euro.

Se i akuzuari ka paraqitur dokument të rremë provohet edhe nga deklaratat të cilat i ka dhënë dëshmitarja A.C. në dy stadet e procedurës penale, e cila ndër të tjera ka mohuar vlerën e pretenduar në dokumentacion të rremë sepse shuma prej 144 mijë e 363 euro, nuk kishte qenë e saktë, ngase qarkullimit bankar kishte qenë 4 mijë e 363 euro, nga rezulton se pjesa tjetër prej 144 mijë ishte e shtuar. Se i akuzuari S.D, kishte falsifikuar dokumentin në fjalë, provohet edhe nga deklarata e dëshmitares së dhënë në polici, ku ka theksuar se: *“Kur është kërkuar verifikimi për lëshim të një dokumenti – konfirmim për subjektin LLC, nga ana e Qendrës së BKT-së, unë nuk kam mundur t’a gjejë në libër të protokollit se kemi lëshuar ndonjë dokument më 14 tetor 2020, për subjektin LLC. Meqë janë klient të bankës unë kam kontaktuar S. D. dhe kam kërkuar se a ka ndonjë dokument që i kam lëshuar unë më 14 tetor 2020, ai më tha po kam dhe më ka sjellë në BKT, dokumentin (i cili i ishte prezentuar edhe gjatë marrjes në pyetje) duke më thënë se ma ke dërguar në viber”*. I akuzuari S.D kishte shkuar përsëri në bankë duke i thënë dëshmitares – zyrtares së bankës *“për atë punën mos ke dert sepse ti nuk ke kurrfarë përgjegjësie”*, përkundër asaj që kategorikisht kishte mohuar një veprim të këtillë (falsifikim të dokumentit). Nën supozimin se banka do t’a lëshonte dokumentin *“Confirmation”* me vlerën (jo të saktë) të qarkullimit bankar, ajo patjetër që do t’a posedonte dokumentin origjinal në fjalë, i njëjti dokument nuk ka mundur që të gjendet në libër të protokollit të bankës BKT, për këtë arsye nuk ka pasur si jetë provë materiale e shkresave të lëndës, por vetëm dokumenti tjetër (i falsifikuar) në gjuhën angleze, që sipas të akuzuarit dëshmitarja ia kishte përcjellur

përmes aplikacionit Viber, meqenëse ishte kohë pandemie. Po ashtu fakti tjetër se i akuzuari S.D kishte shkuar në bankë duke i thënë dëshmitares se: “*për atë punën mos ke dert sepse ti nuk ke kurrfarë përgjegjësie*” i njëjti në rastin konkret ka qenë i vetëdijshëm për pasojat e një veprimi të tillë, duke bartur përgjegjësinë për pasojat eventuale të veprimit konkret. Gjendja faktike (në raport me dokumentin e falsifikuar të BKT-së) provohet edhe nga Përgjigja e bankës BKT, me 11 Maj 2022 me anë të së cilës Banka – Zyrtarët kompetent e kanë njoftuar Policinë e Kosovës, se Dokumenti “*Confirmation*” me të dhënat: Klienti L.L.C, me nr. unik, me adresë: Rr. “...” nr. ...B, City P..., Account, nuk është lëshuar nga BKT. Si dhe sipas verifikimeve të bëra nga zyrtarët kompetent të BKT-së, në gjendjen e llogarisë së klientit L.L.C, me nr. të Account, ju konfirmojmë se qarkullimi deri më 14 tetor 2020 është 4,363.00 euro dhe data e hapjes së llogarisë është 14 maj 2020. Me këtë provë gjykata pa mëdyshje ka vërtetuar faktin se dokumentin nuk e ka lëshuar banka, i njëjti dokument ka qenë i falsifikuar dhe me anë të së cilit i akuzuari ka vënë në lajthim institucionet publike duke prezantuar dokument të rremë gjatë procedurës së prokurimit publik, se kinse i njëjti ka qarkullim bankar në vlerë prej 144,363.00 euro dhe me rastin konkret ka arritur që të nënshkruaj tre kontratat me Institucionet Publike të Republikës së Kosovës dhe atë më 20 janar 2021 Operatori Ekonomik LLC ka lidhur kontratë me Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për “Sigurim Fizik për KM”, vlera e kontratës 18,000.00 (tetëmbëdhjetë mijë) euro, më 14 maj 2021 ka lidhur kontratë me Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për “Mirëmbajtjen Higjienike” të Objektit të Sekretariatit të KGJK-së në G... dhe Objektin e Divizionit të Gjykatës se Apelit me seli në M. e V..., vlera e kontratës 65,244.96 si dhe më 26 prill 2021, ka lidhur kontratë me Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve për “Pastrimin dhe Mirëmbajtjen” e objektit në shfrytëzim nga “MFPT”, vlera e kontratës 11,149.92, që gjendja faktike provohet nga provat materiale të administruara më sipër, gjegjësisht kontratat e lidhura në mes të Operatori Ekonomik LLC dhe tre Institucioneve të publike të lartcekura.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare, e duke mos u lidhur me kualifikimin ligjor të prokurori të shtetit, ka hequr pjesën e cila i referohet institutit të bashkëkryerjes, në raport me të akuzuarin A.D. Gjendja faktike është ndryshuar ashtu siç është vërtetuar me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe se gjendja faktike e përshkruar në raport me të akuzuarin S.D në mënyrë të plotë përputhet me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Vendimi i gjykatës për t'a shpallur të akuzuarin S.D fajtor

Gjykata pas administrimit të të gjitha provave personale dhe materiale, ka vërtetuar pa mëdyshje se me veprimet e lartcekura të të akuzuarit S.D, konsumohen elementet qenësore të figurës së veprës penale Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik nga neni 415 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 3 të KPRK-së dhe pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi i gjykatës për pjesën liruese në raport me të akuzuarin A.D

Gjykata, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të lartcekura si dhe vlerësimit me ndërgjegje të secilës provë një nga një dhe në lidhje reciproke me njëra - tjetrën, konform neni 360 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së, nuk ka arritur që të vërtetojë përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se i akuzuari *të ketë ndërmarrë veprime të cilat bëjnë pjesë në kuadër të veprimeve kryerëse* me qëllim të ndikimit në vendimin e një autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit publik, ashtu siç është parashikuar në nenin 415 paragrafi 1 dhe 3 të KPRK.

Nga dispozitivi i aktakuzës rezulton se: *“I akuzuari A.D - Pronar i Kompanisë LLC në bashkëkryerje me të akuzuarin S.D - Përfaqësues i kompanisë me vetëdije ka shkelur rregullat e prokurimit publik duke paraqitur dokumentacion të rremë, në atë mënyrë që ka përpiluar kontrata fiktive kinse të lidhura mes kompanisë L.L.C dhe kompanive “R...” SHA, N.T.P “D...” dhe KS “R.S.” të cilat i kanë paraqitur si referenca në dosjet e tenderëve në vitin 2021, të cilat referenca nuk janë fare të deklaruara në qarkullimin e Administratës Tatimore të Kosovës sipas procedurave fatura shitje - blerje dhe në Bankën Kombëtare Tregtare, si dhe ka falsifikuar dokumentin e datës 14 tetor 2022 kinse të lëshuara nga BKT, të cilin dokument e ka përdorur në procesin e tenderimit, me ç’rast i njëjti ka vënë në lajthim autoritetet kontraktuese dhe ka arritur që të nënshkruaj tre kontratat me Institucionet e Republikës së Kosovës”.*

Në rastin konkret është i fakt i pa kontestueshëm se i akuzuari A.D, në vitin në vitin 2021 ka qenë pronar i biznesit – kompanisë LLC, ndërsa arsyeja pse biznesi ka kaluar në emër të tij kishte qenë se kundër të të akuzuarit S.D (prindit të tij) si pronar i biznesit në fjalë (që nga muaji dhjetor i vitit 2015), aso kohe ishte iniciuar procedurë penale dhe i njëjti nuk kishte pasur mundësi që të pajiset me licencë, si pasojë e të kaluarës kriminale e cila i figuronte në certifikatë, e që kjo gjendje faktike provohet nga të dhënat e siguruara përmes Sistemit të Evidencës Penale të kësaj gjykate, nga rezulton se i akuzuari S.D kishte qenë i dënuar – gjykuar

me 20 vendime të formës së prerë (që të gjitha detajisht të specifikuar tek vendimi mbi sanksionin penal). Në rastin konkret shtrohet pyetja se cilat veprime konkrete janë ndërmarrë nga i akuzuari A.D në drejtim të kësaj veprë meqenëse i njëjti me të akuzuarin S.D akuzohen se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale në fjalë. Pra, cili ka qenë veprimi konkret i të njëjtit në raport me falsifikimin e dokumentit të bankës BKT dhe cilat veprime i ka ndërmarrë i njëjti në procesin e tenderimit, ku janë nënshkruar tre kontratat me Institucionet e Republikës së Kosovës?! Nga kjo rezulton se prokuroria në rastin konkret ka dështuar që të vërtetojë gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv, ngase me provat e administruara provohet një tjetër gjendje faktike. Nga deklarata e dëshmitarit M.H., nuk është vërtetuar fajësia e të akuzuarit A.D, për arsyet si në vijim: i njëjti (dëshmitari) sipas kontratës së punës ka qenë si menaxher i sigurimit fizik ndërsa detyra e tij ka qenë të merret me prokurim elektronik ndërsa lidhur me raportin e tij në marrëdhënie të punës me të akuzuarin A.D i cili figuron pronar në Agjencionin "... LLC, ka theksuar se lidhur me punën e tij kurrfarë kontakti nuk ka pasur me të akuzuarin A.D për punën e tij është përgjigjur tek i akuzuari S.D i cili e ka punësuar dhe se asnjëherë nuk ka pasur kurrfarë kontaktesh e as kërkesë lidhur me kompletimin e dokumenteve – dosjes së tenderit, ku të gjitha dokumentet për procedurë të tenderimit kanë qenë të përgatitura dhe të nënshkruara nga i akuzuari S.D. Nga kjo provohet fakti se përkundër asaj se akuzuari figuron si pronar i biznesit në fjalë, i njëjti nuk ka ndërmarrë veprime konkrete në kuadër të biznesit dhe fakti se i njëjti ka qenë pronar nuk e bënë person përgjegjës për veprimet të cilat janë ndërmarrë nga përfaqësuesi i kompanisë, i cili kishte autorizim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, në këtë rast prindi i tij i akuzuari S.D. Referuar provës materiale të sipër administruar Autorizimi për përfaqësime të kompanisë L.L.C, i datës 26 mars 2024, është vërtetuar fakti se Pronari i kompanisë së lartcekur A.D, e ka autorizuar S.D, si Drejtor i Kompanisë, që mund të merr pjesë në çdo tender, mund të nënshkruaj në emër të tij (A.D) dhe në emër të kompanisë, të merr pjesë në mbledhje dhe të përfaqësoj Kompaninë L.L.C, të e drejtoj, menaxhoj kompaninë, si dhe posedon të gjitha të drejtat tjera mbi kompaninë L.L.C. Autorizimi në fjalë është nënshkruar nga të dy palët, këtu të akuzuarit A.D dhe S.D. Me një autorizim të këtillë të gjitha të drejtat në raport me përfaqësimin e kompanisë i ka pasur i akuzuari S.D, pra i akuzuari A.D, vetëm formalisht ka ekzistuar pronar. I njëjti nuk ka pasur dijëni lidhur me procedurat e prokurimit, dokumentacioni është përpiluar nga prindi i tij. Po ashtu sistemi E-prokurimi kishte figuruar në emër të të akuzuarit S.D , i cili i kishte dhënë tagër dëshmitarit M.H., i punësuar në kompani për të hyrë në sistem dhe të ndërmarrë veprime të caktuara dhe se për secilin njoftim nga autoritetet kontraktuese të e njoftojë të njëjtin. Pra, e gjithë procedura është zhvilluar dhe përfunduar me veprimet konkrete të cilat janë marrë nga i

akuzuari S.D dhe për veprimet e këtilla nuk mund të gjendet fajtor edhe i akuzuari A.D, vetëm pse firma ka figuruar në emër të tij, marrë parasysh edhe nënshkrimin e vendosur në vulë, për firmosje të dokumentacionit. Po ashtu gjendja faktike provohet edhe nga deklaratat e dy të akuzuarve S.D dhe A.D , të cilët kategorikisht kanë mohuar ndërmarrjen e veprimeve të akuzuarit A.D, në kuadër të biznesit LLC, ku evidentohet pronar, të cilave deklaratave iu ka falur pjesërisht besimin.

Rrjedhimisht mbi bazën e të cekurave më lartë dhe duke ju përmbajtur plotësisht përshkrimin të gjendjes faktike si në dispozitiv të aktakuzës, kjo gjykatë përfundimisht konsideron se në rastin konkret nuk është provuar se i akuzuari A.D, ka kryer veprën penale në bashkëkryerje sipas aktit akuzues. Gjykata rikujton një prej parimeve të rëndësishëm të procedurës penale “*in dubio pro reo*”, i paraparë me nenin 3 të KPPR-së, ku sipas këtij parimi përcaktohet se: “*Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij*”, ashtu që mos vërtetimi i ndërmarrjes së veprimeve konkrete dhe përfitimit material në kryerjen e veprës penale, konform nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-së, të akuzuarin e ka liruar nga akuza, ngase nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Vendimi i gjykatës në raport me propozimin e mbrojtjes së të akuzuarit S.D

Gjykata propozimin e mbrojtësit të të akuzuarit A.D, avokat V.O , në shqyrtimin gjyqësor të datës 10 tetor 2024, që zyrtarisht nga banka BKT, të kërkohet nënshkrimi i kontratës mbi hapjen e llogarisë, kur është bërë hapja e llogarisë, aktivitetet në këtë llogari bankare, personat e autorizuar për këtë llogari bankare, me aktvendim procedural e ka refuzuar një propozim të këtillë me arsyetimin se me dokumentin e lëshuar nga BKT me numër të protokollit ..., të datës 11 maj 2022 është sqaruar mjaftueshëm se dokumenti “Confirmation” me të dhënat e lartcekura nuk është lëshuar nga banka BKT. Po ashtu në rastin konkret është sqaruar se kur është hapur llogaria bankare në emër të LLC, më 14 maj 2020, qarkullimi deri me datë 14 tetor 2020 ka qenë 4,363 euro, ndërsa sa i përket personave të autorizuar për këtë llogari bankare, ky propozim apo kjo përgjigje nuk ka paraqitur ndonjë relevancë lidhur me çështjen konkrete, përkundër se dëshmitarja – zyrtarja e bankës A.C., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka sqaruar procedurat e brendshme të bankës se kush pos pronarit legjitim të llogarisë bankare, ka të drejtë të ketë qasje në atë llogari bankare.

Vlerësimi i gjykatës në raport me deklaratimet e të akuzuarit S.D

Gjykata me vëmendje ka analizuar të gjitha deklaratimet e dhëna nga i akuzuari S.D gjatë shqyrtimit gjyqësor, pjesës së deklaratës në të cilën ka sqaruar pse biznesi i tij LLC, ka kaluar në emër të djalit të tij A.D dhe se prej hapjes së biznesit në fjalë e deri në kohën e këtij procesi gjyqësor i njëjti ka ndërmarrë të gjitha veprimet lidhur me atë biznes, duke përfshirë edhe përgatitjen e dokumentacioneve për aplikim për tender, kjo gjykatë ia ka falur besimin. Po ashtu edhe pjesës së deklaratës ku ka theksuar se djali i tij A. në cilësi të drejtorit të kompanisë, ka pasur ka zero ndikim dhe zero përgjegjësi sa i përket menaxhimit të biznesit në fjalë dhe se vetëm formalisht ekziston në letër sepse i njëjti është pronari dhe bartë përgjegjësi për të gjitha bizneset përfshirë biznesin LLC si dhe vula e zyrës me të cilën janë firmosur dokumentet përkatëse ka qenë më nënshkrim të djalit të tij A.D, kjo gjykatë po ashtu ia ka falur besimin, ngase dëshmia e tij gjen mbështetje në provat e sipër administruara në këtë çështje penale. Sa i përket pjesës së deklaratës së tij përkatësisht me dokumentin (e falsifikuar) të BKT-së, ku sipas të njëjtit e kishte pranuar nga zyrtarja e bankës përmes aplikacionit viber, për shkak se kishte qenë kohë pandemie dhe se nuk ka ndërhyrë në dokument, kjo gjykatë nuk ia ka falur besimin, ngase nuk ka gjetur mbështetje me asnjë provë të vetme, mbi bazën e të cilave edhe është shpallur fajtor.

Vlerësimi i gjykatës në raport me deklaratimet e të akuzuarit A.D

Gjykata me vëmendje ka analizuar të gjitha deklaratimet e dhëna nga i akuzuari A.D gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor. Pothuajse të gjitha deklaratimet e tij kanë qenë në përputhje me provat e sipër administruara, për çka edhe i njëjti është liruar nga aktakuza.

Vlerësimi i gjykatës në raport me deklaratimet e mbrojtjes së të akuzuarit S.D

Gjykata me vëmendje ka analizuar edhe pretendimet e parashtruara nga mbrojtja e të akuzuarit S.D, sipas të cilit nuk është provuar se i mbrojturi i tij të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, pretendim ky që nuk qëndron, ngase nga të gjitha provat e administruara është vetëtuar fajësia e të akuzuarit S.D. Në raport me pretendimin se nga deklarata e dëshmitares A.C. nuk është arritur që të dëshmohet lidhur me rastin e dokumentit me logo të BKT-së, me mbishkrimin “*Confirmation*”, ngase e njëjta kishte qenë konfuze gjatë dy deklaratave të dhëna

atë në prokurori dhe gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, edhe një pretendim i këtillë nuk qëndron ngase gjykata me vëmendje ka analizuar dy deklaratat e dhëna në dy stadet e procedurës penale, përkatësisht përmbajtjen e tyre, të njëjtat nuk kanë diskrepancë mbi të gjitha qartë pasqyrojnë gjendjen faktike lidhur me dokumentin e falsifikuar nga i akuzuari. Sa i përket pretendimit të Prokurorisë lidhur me shkeljen e rregullave të prokurimit publik duke paraqitur kinse dokumentacion të rremë, në atë mënyrë që kanë përpiluar kontrata fiktive të lidhura mes kompanisë L.L.C dhe kompanive “R....” SH.A, N.T.P “D....” dhe KS “R.S.”, të cilat i kanë paraqitur si referenca në dosjet e tenderëve në vitin 2021 të cilat referenca nuk janë fare të deklaruara në qarkullimin e ATK-së, sipas procedurave fatura shitje-blerje, me asnjë provë të vetme apo thirrje ligjore konkrete nuk ka vërtetuar se i akuzuari S.D në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar të kompanisë L.L.C ka shkelur rregullat e prokurimit publik dhe se Bizneset lartcekura janë biznese plotësisht legjitime të regjistruara në ARBK, edhe ky pretendim për gjykatën nuk ka qenë i pranueshëm, ngase nuk ka provuar se dokumentet përkatëse nuk kanë qenë të sakta, për të cilat ka dhënë arsye të mjaftueshme më sipër, gjegjësisht tek gjendja faktike e vërtetuar në raport me të akuzuarin S.D.

Vlerësimi i gjykatës në raport me deklaratimet e mbrojtjes së të akuzuarit A.D

Gjykata me kujdes ka analizuar pretendimet e mbrojtjes të të akuzuarit A.D - avokat V.O të parashtruara lidhur me rastin konkret duke mohuar se i mbrojturi i tij është inkriminuar në veprën penale të përshkruar si në aktin akuzues të prokurorisë, e që fakt i pakontestueshëm në këtë çështje penale mbetet vetëm se i akuzuari A.D është pronar i subjektit L.L., bazuar në ndryshimet statutare të bëra në këtë subjekt në vitin 2020, ku edhe tani i njëjti formalisht është pronar i këtij subjekti. Nga provat personale, përkatësisht deklarata e dëshmitarit M.H. (i punësuar në subjektin L.L) ka dëshmuar se të gjitha veprimet në emër të subjektit në fjalë dhe përgatitja e gjithë dokumentacionit është bërë nga i akuzuari S.D. Sa i përket pretendimit tjetër të prokurorisë, në raport me mos paraqitjen e faturave në ATK si qarkullim i shitjes dhe blerjes nuk janë elemente ligjore që përcaktojnë se një kontratë a është fiktive apo jo, por mund të jenë elemente të përgjegjësisë së shmangies tatimore e në asnjë rrethanë ligjore nuk i bënë këto kontrata fiktive në kuptim të LMD-së. Po ashtu pretendimi i Prokurorisë se i akuzuari A.D ka falsifikuar edhe dokumentin e lëshuar nga BKT, të datës 14 tetor 2022, i cili dokument po ashtu është shfrytëzuar në procedurën tenderuese, nga provat e administruara është vërtetuar fakti se i akuzuari A.D nuk ka pasur njohuri në përgatitjen e këtij tenderi në aspektin e sigurimit të dokumentacioneve, e aq më pak të nxjerrjes së saj nga banka. Evidentimi formal i tij në

ARBK si pronar i Subjektit L.L.C dhe mos ndërmarrja e asnjë veprimi lidhur me menaxhimin e subjektit nuk e bënë të jetë penalisht përgjegjës edhe për veprimet e personave të tjerë pasi që përgjegjësia është individuale. Pretendimet e këtilla të cilat janë parashtruar nga mbrojtja e të akuzuarit, për gjykatën kanë qenë të pranueshme, mbi bazën e të cilave si dhe provave të cilat janë administruar gjatë këtij procesi gjyqësor të njëjtin e ka liruar nga akuza.

Vendimi mbi sanksionin penal

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 me të cilën dispozitë janë përcaktuar rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, si dhe nenin 70 me të cilën dispozitë janë përcaktuar rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit.

Gjykata në rastin konkret për të akuzuarin e lartcekur nuk gjeti asnjë rrethanë lehtësuese.

Si rrethanë rënduese gjykata për të akuzuarin ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale të te njëjtit të kryer me dashje direkte dhe paramendim, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, faktin se vepra penale është kryer nga një person që ka të përfunduar fakultetin ekonomik dhe me çështje të biznesit merret që nga periudha e pas luftës, si dhe faktin tjetër se veprën penale e ka kryer me qëllim të përfitimit në mënyrë të kundërligjshme. I njëjti është person recidivist ku edhe më parë ka rënë ndesh me ligjin duke u gjykuar – dënuar (për vepra të ndryshme penale) me vendime (20) të cilat tashmë kanë marrë formën e prerë dhe atë: 1. P.1153/2015, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 29 qershor 2017, vepra penale: Cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës, nga neni 221 të KPRK-së, i dënuar me kusht tre (3) muaj burgim në afat verifikimi prej një (1) viti; 2. P.511/2015, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 04 mars 2016, vepra penale: Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së, i dënuar me kusht gjashtë (6) muaj burgim, në afat verifikimi prej një (1) viti; 3. P-649/2017, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 07 maj 2018, vepra penale: Kanosja nga neni 185 të KPRK-së, i dënuar me kusht gjashtë (6) muaj burgim, në afat verifikimi prej një (1) viti; 4. P-2105/2016, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 18 prill 2018, vepra penale: Lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, i dënuar me kusht, gjashtë (6) muaj, me burgim dhe gjobë në shumë prej 150,00 (njëqind e pesëdhjetë) euro, në afat verifikimi prej një (1) viti; 5. P-2018/2015, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 27 tetor 2016, vepra penale: Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i dënuar me kusht gjashtë (6) muaj me burgim në afat

verifikimi prej një (1) viti dhe gjobë 200,00 (dyqind) euro; 6. P-1499/2016, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 22 janar 2019, vepra penale: Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së, i dënuar më gjobë në shumë prej 200,00 euro; 7. P-594/2009, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 05 prill 2011, vepra penale: Dëmtimi i të drejtave të personit tjetër nga neni 271 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPK), i dënuar me kusht dy (2) muaj burgim, në afat verifikimi prej një (1) viti; 8. P-283/2019, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 13 mars 2020, vepra penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 të KPRK-së, i dënuar me gjobë 400,00 (katërqind) euro; 9. P-1723/2004, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 17 nëntor 2005, vepra penale: Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë, nga neni 334 të KPK-së, i dënuar me dënim me kusht pesë (5) muaj burgim, në afat verifikimi prej një (1) viti; 10. P-1314/2003, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 27 shtator 2007, vepra penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 të KPK-së, i dënuar me kusht gjashtë (6) muaj me burgim në afat verifikimi prej një (1) viti; 11. P-1471/2003, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 11 maj 2006, vepra penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 të KPK-së, i dënuar më gjobë në shumë prej 200,00 (dyqind) euro; 12. P-434/2016, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 29 nëntor 2016, vepra penale: Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i dënuar me kusht gjashtë (6) muaj me burgim në afat verifikimi prej një (1) viti; 13. P-2017/2015, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 03 korrik 2017, vepra penale: Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i dënuar me kusht tre (3) muaj burgim, në afat verifikimi prej një (1) viti dhe dënim me gjobë 300,00 (treqind) euro; 14. P-566/2021, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 29 tetor 2021, vepra penale: Shmangia nga tatimi nga neni 313 të KPRK-së, i dënuar me në gjobë prej 2,500.00 (dy mijë e pesëqind) euro; 15. P-780/2020, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 22 tetor 2021, vepra penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 të KPRK-së, i dënuar me gjobë 200,00 (dyqind) euro; 16. P-1523/2019, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 07 prill 2022, vepra penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 të KPRK-së, i dënuar me gjobë 400,00 (katërqind) euro; 17. P-210/2019, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 12 korrik 2022, vepra penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 të KPRK-së, i dënuar me gjobë 400,00 (katërqind) euro; 18. P-829/2021, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 18 tetor 2023, vepra penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 të KPRK-së, i dënuar me gjobë 200,00 (dyqind) euro; 19. P-933/2019, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së prerë më 13 qershor 2024, vepra penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 të KPRK-së, i dënuar me gjobë 300,00 (treqind) euro dhe 20. P-7/2024, Gjykata Themelore në Prizren, i formës së

prerë më 04 korrik 2024, vepra penale: Shmangia nga tatimi nga neni 307 të KPRK-së, i dënuar me gjobë 2,700.00 (dymijë e shtatëqind) euro. Vendimet e lartcekura gjykata i ka siguruar nga Sistemi i Evidencës Penale të kësaj gjykate.

Sa i përket dënimit me gjobë në këtë rast për të akuzuarin gjykata, përveç rrethanave të cekura më sipër, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të akuzuarin është i përballueshëm për kushtet ekonomike dhe të ardhurat që realizon i njëjti.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave gjykata konsideron se me këtë dënim kryesi i veprës penale do t'a kuptojë rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektojë që në të ardhmen mos të shkaktojë veprime të ndaluara, përkatësisht mos të kryej veprë të re penale. Tutje, gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen e kryesit, me rrethanat e kryerjes, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, si dhe me përgjegjësinë e kryesit. Sipas bindjes së gjykatës, ky dënim përveç që do të e mundësojë risocializimin dhe riedukimin e kryesit, i njëjti do të ndikojë edhe tek tjerët që të mos kryejnë vepra penale, gjegjësisht do të ndihmojë në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme lidhur me detyrimin për respektimin e ligjit, që është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në ndalim

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në ndalim të te akuzuarit S.D , është marrë konform neni 79 paragrafi 1 të KPRK-së, me të cilën dispozitë është përcaktuar se: *“Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, në masën edukative institucionale dhe dënimin me gjobë”*, ashtu që të akuzuarit të lartcekur ia ka llogaritur kohën e kaluar në ndalim nga data 12 maj 2022 deri më datë 13 maj 2022.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim, është marrë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, me të cilën dispozitë është paraparë se: *“Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me gjobë zëvendësohet me dënim me*

burgim, njëzet (20) euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim. Dënimi me burgim nuk mund të tejkalohet tre (3) vjet”.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues

Vendimi për shqiptimin dënimit plotësues, krahas dënimit kryesor: Ndalimi i marrjes pjesë në procedurat për dhënien e kontratave në prokurim publik në kohëzgjatje prej tre (3) viteve të te akuzuarit S.D, është marrë konform nenit 415 paragrafi 4 të KPRK-së, më të cilën është përcaktuar se: *“Në rastet e shpalljes fajtor të kryerësit, përveç dënimit, gjykata do t’i shqiptojë kryerësit ndalimin e marrjes pjesë në procedurat për dhënien e kontratave në prokurim publik”.*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor në raport me pjesën dënuese është marrë konform nenit 452 paragrafi 1 të KPPRK-së, ndërsa lidhur me pjesën liruese vendimi në fjalë është marrë konform nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së. Vendimi në emër të kompensimit të Viktimave të Krimit është marrë, konform nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligjit nr.08/L-109).

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, si dhe nenit 363 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Kodit të sipërcekur, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Krimeve të Rënda

PKR.nr.596/22, më 23 dhjetor 2024

Zyrtare ligjore,
Dalina Kërçeli - Abdullahu

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari,
Gazmend Bahtiri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në

Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për gjykatën dhe palët.